



## OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

### DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

**Drejtuar:** OE “MAZARS” sh.p.k. me NIPT K32123006W  
Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga “Emin Duraku”, Pallati  
Binjakët Nr. 5, Kati 1 teknik, Ap. 1&2.

**Procedura e prokurimit:** “E hapur e thjeshtuar” me mjete elektronike – Shërbime.

**Numri i referencës së procedurës:** REF-85553-10-27-2023

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Auditimi nga një shoqëri e pavarur audituese i Pasqyrave Financiare të konsoliduara të OST sh.a. për vitin 2023 sipas Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit”.

**Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):** Buletini i Njoftimeve Publike Data 06.11.2023, Nr. 90.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim.

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. OE “GRANT THORNTON” sh.p.k. me NIPT K91923007M**

Vlera 2,280,000 (dy milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

**2. OE “MAZARS” sh.p.k. me NIPT K32123006W**

Vlera 2,300,000 (dy milion e treqind mijë) Lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. OE “GRANT THORNTON” sh.p.k., me NIPT K91923007M, për arsye se:**

- Nuk ka përmbushur pikën 1/e, të Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit, pasi nuk ka shlyer detyrimet e maturuara të energjisë elektrike për muajt Gusht dhe Shtator 2023.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1 të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur kopje të certifikuar të bilancit për vitin 2022, sipas kërkesës së Dokumenteve të Tenderit.
- Oferta e paraqitur nga OE është në kundërshtim me pikën 5, të nenit 42, të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009, ku përcaktohet se:

“Audituesi ligjor, që është person fizik dhe audituesi ligjor apo ortak kryesor në një shoqëri audituese, që është audituesi ligjor përgjegjës për kryerjen e auditimit, në emër të shoqërisë së auditimit, duhet të zëvendësohet për kryerjen e auditimit brenda një periudhe maksimale prej 7 vjetësh nga data e caktimit si auditues ligjor dhe mund të rimarrë pjesë në auditimin e shoqërisë pas mbarimit të një afati kohor prej, të paktën, dy vjetësh.”

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “MAZARS” sh.p.k.**, me **NIPT K32123006W**, Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga “Emin Duraku”, Pallati Binjakët Nr. 5, Kati 1 teknik, Ap. 1&2, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **2,300,000 (dy milion e treqind mijë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 9, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar dhe tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

**ADMINISTRATORI I OST SH.A.**

**Skerdi Drenova**